



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.5, datë 21.11.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMIT UJOR
KURATIV, MINERAL, TERMOMINERAL DHE GJEOTERMAL”
SUBJEKTIT “XHEVIT ÇEKREZI”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit uJOR, e lejes/autorizimit për përdorim burimi uJOR, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit uJOR, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit UJOR Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimit uJOR kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal, subjektit “Xhevit Çekrezi”, me vendndodhje Njësia Administrative Tregan Elbasan Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për burimin sipas KRGJSH

- X= 506241.3; Y= 4544102.7; Z= 146 m.m.n.d

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shfrytëzimit sipas KRGJSH

- X= 506226.7; Y= 4544090.7; Z= 146 m.m.n.d

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shkarkimit sipas KRGJSH

- $X= 506224.8$; $Y= 4544082.3$; $Z= 146$ m.m.n.d
 - Prurja e kërkuar: $Q= 0.3$ l/sek
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

